

DITA BOTËRORE E DHURIMIT TË GJAKUT

14 Qershori

“Një Pikë Humanitet. Dhuro Gjak. Shpëto Jetë.”

Çdo vit më 14 qershor bota bëhet bashkë për ta shënuar Ditën Botërore të Dhurimit të Gjakut, një homazh global për miliona dhurues vullnetarë të gjakut, bujaria e të cilëve shpëton jetë të panumërta çdo ditë.

Fushata e këtij viti “Një Pikë Humanitet. Dhuro Gjak. Shpëto Jetë” e vendos humanitetin në zemër të çdo dhurimi gjaku. Na kujton se çdo dhurim është më shumë sesa një akt mjekësor: është një shprehje e fuqishme e solidaritetit, dhembshurisë dhe përgjegjësisë kolektive. I frymëzuar nga ideja se i gjithë njerëzimi mund të reflektohet në një pikë të vetme, fushata thekson se si çdo dhurues ndihmon në krijimin e një litari shpëtimi që na lidh dhe na mbron të gjithëve.

Dhurimi i gjakut është thelbësor për sistemet e mbrojtjes shëndetësore në të gjithë botën, duke i mbështetur pacientët gjatë urgjencave (ndërhyrjeve), lindjes së fëmijëve, operacioneve, trajtimit të kancerit dhe kujdesit gjatë gjithë jetës për shumë gjendje serioze.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë qëllimet e fushatës së këtij viti janë:

- sigurimi i rritjes së qëndrueshme të dhurimeve të rregullta, vullnetare dhe të papaguara të gjakut në mbarë botën;
- rritja e ndërgjegjësimit për ndikimin shpëtues të jetës së dhurimeve të gjakut dhe plazmës;
- theksimi i kontributit jetësor të dhuruesve të gjakut dhe promovimi i vlerave të solidaritetit dhe humanizmit; dhe
- inkurajimi i qeverive dhe partnerëve për t'i forcuar dhe investuar në programet kombëtare të dhurimit të gjakut, me qëllim arritjen e qasjes universale në transfuzione të sigurta gjaku.

Bashkë ne mund të ndihmojmë në sigurimin që gjaku i shëndetshëm të jetë i disponueshëm për të gjithë, kudo, sa herë që është më i nevojshëm.

Dhurimi i gjakut ka një rëndësi të theksuar shoqërore dhe është një aktivitet me interes të përgjithshëm për Republikën e Maqedonisë. Pa sasitë e nevojshme të gjakut dhe produkteve të gjakut nuk është e mundur të ofrohet mbrojtje shëndetësore moderne dhe cilësore.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhurimi i gjakut është vullnetar dhe kryhet përmes fushatave të dhurimit të gjakut të organizuara nga Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë, me ndihmën e ekipeve të ekspertëve nga Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit - Shkup.

Programi përfaqëson mbështetje për dhurimin e gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe përmban masa dhe aktivitete për organizimin dhe zbatimin e fushatave të dhurimit të gjakut. Ministria e Shëndetësisë përcakton nevojat e vendit për njësi gjaku, produkte gjaku dhe rezerva, në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit dhe mbikëqyr pjesëmarrësit në zbatimin e Programit dhe krijon një sistem cilësie.

Dhurues gjaku mund të jetë çdo person i moshës 18 deri në 65 vjeç, që peshon të paktën 50 kilogramë dhe gëzon shëndet të përgjithshëm të mirë.

Dhurimi i gjakut është vullnetar dhe pa kompensim financiar. Dhurimi i gjakut ka edhe përfitime shëndetësore për vetë dhuruesit. Dhurimi i rregullt i gjakut mund ta përmirësojë shëndetin e përgjithshëm dhe ta zvogëlojë rrezikun e sëmundjeve të caktuara.

Çdo person ka një grup të caktuar gjaku, pavarësisht nga gjinia. Ai përcaktohet nga një palë gjenesh, një gjen i trashëguar nga secili prind. Çdo grup gjaku identifikohet nga grupi i vet i molekulave (të quajtura antigjene) që gjenden në sipërfaqen e qelizave të kuqe të gjakut.

Gripi O i gjakut, i quajtur edhe "dhuruesi universal", është ndoshta gjaku më i vlefshëm në botë sepse mund të transfuzohet në pothuajse çdo grup gjaku (përveç kur personi ka një antigjen të rrallë jashtë atyre kryesorë).

Në periudhën nga 19-25 janari 2026 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut po organizon fushata për dhurimin e gjakut në disa qytete, Manastir, Ohër, Gostivar, Shkup, Probishtip, Radovish dhe Krushevë.

Më 17 shkurt 2026, në ambientet e ISHP - Institutit të Shëndetit Publik - Shkup, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë dhe një ekip nga Instituti i Mjekësisë Transfuzive - Shkup, u zbatua një fushatë për dhurimin e gjakut, me qëllim që të ndihmohen pacientët që kanë nevojë për gjak dhe të inkurajohet solidariteti dhe bashkimi.

Punonjësit e të dy institucioneve (Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik - Shkup), iu bashkuan fushatës dhe kontribuan në shpëtimin e jetëve njerëzore sepse besojnë se "Një vepër e mirë mund ta ndryshojë botën e dikujt".

Me këtë akt simbolik, por jashtëzakonisht të rëndësishëm, ne edhe një herë konfirmuam humanitetin dhe gatishmërinë tonë për ta mbështetur sistemin e mbrojtjes shëndetësore dhe të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmë.

Të bëhemi pjesë e ndryshimit që sjell shpresë, thuhet në njoftimin në faqen e Facebook-ut të Institutit.

Gjaku i njeriut nuk njeh ndarje kombëtare, fetare, etnike, gjinore, fetare dhe të tjera për dhuruesit e këtij "lëngu të çmuar". Prandaj, të bëhemi pjesë e fushatës së këtij viti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, "Një pikë humaniteti. Dhuroni gjak. Shpëtoni jetë". dhe me pikën tonë të humanitetit, le t'i japim dikujt një shans të ri për jetën.

Instituti i Shëndetit Publik u bën thirrje publike të gjithë qytetarëve, "mos prisni të thirreni, jini humanë dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e gjakut tuaj të dhuruar".

Burime:

World Blood Donor Day 2026: One Drop of Humanity. Give Blood. Save Lives.

П Р О Г Р А М А ЗА ОРГАНИЗИРАЊЕ И УНАПРЕДУВАЊЕ НА КРВОДАРИТЕЛСТВОТО ВО РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА ЗА 2024 ГОДИНА (усогласен текст)

Светски ден на крводарителството - македонските граѓани се хумани, даруваат крв и спасуваат животи - Независен Весник

world blood donor day 2026 - Search Images

Крводарителски акции - | Црвен Крст на Република Северна Македонија

<https://www.facebook.com/share/18jBUpESUj/>

Крвни групи-која е најретка, а која е најдобра за луѓето - Ранасеа.mk крвни групи - Search Images